



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

**V E N D I M**

**Nr. 07, Datë 03 / 03 / 2017**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 16, datë 12.02.2016, të bërë nga A.Z, kundër Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatri i Kukullave në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*Aftësisë së kufizuar*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

A.Z në ankesën e tij deklaroi se: “*Ka qenë i punësuar pranë QKKF që prej vitit 2005 në detyrën si aktor i parë. Ndryshe nga praktika e ndjekur më parë dhe ndryshe nga aktorët e tjerë kontrata e punës e lidhur mes tij dhe QKKF në dhjetor 2015 është me afat 6-mujor, ndërkohë që për aktorët e tjerë është me afat 1-vjeçar. Kohët e fundit ankuesi ka patur një lloj përkeqësimi të gjendjes së tij shëndetësore e cila konsiston në një lloj reumatizme dhe shtypje vertebrale. Kjo gjendje është e kurueshme dhe e trajtueshme dhe këtë trajtim ankuesi e merr nëpërmjet fizioterapisë, gjithashtu këto shqetësime kërkojnë kushte të përshtatura, psh. ambient të ngrohtë. Të qëndruarit për një kohë të gjatë në një ambient të ftohtë e përkeqëson gjendjen e A.Z. Ankuesi pretendon se në ambientin e tij të punës është diskriminuar dhe vendosur në një pozitë të pafavorshme në raport me kolegët e tjerë për shkak të aftësisë së kufizuar, dhe ky fakt provohet në këto drejtime:*

1. *Nëpërmjet kufizimit të kohës së punësimit të ankuesit. QKKF-ja qëllimisht për shkak të aftësisë së kufizuar të tij, ndryshe nga punonjësit e tjerë, kontratën me të e ka lidhur me një afat më të shkurtër, ndryshe nga aktorët e tjerë.*
2. *Gjatë kësaj kohe ankuesi ka vënë re një tendencë për ta shmangur atë nga shfaqjet duke mos i dhënë role mjaftueshëm, pavarësisht aftësisë së tij të kufizuar ai ka qenë gjithmonë*

*aktiv në shfaqje, me role të përshtatura ose jo. Aktualisht kur gjendja e tij shëndetësore nuk është mjaft e mirë ai kurohet dhe nuk është në atë gjendje sa të përjashtohet nga aktivitetet artistike. Nëse dhe kushtet në teatër do të ishin brenda standardeve (duke iu referuar ngrohjes) ai do të gjendej akoma më mirë.*

3. *Në shfaqjet e ashtuquajtura “me gropë”, A.Z është refuzuar gjithnjë të marrë pjesë për shkak të shtatlartësisë së tij. Për zgjidhjen e kësaj çështje ankuesi ka propozuar një lloj ndërhyrje në prapaskenë e cila nuk do të pengonte atë të merrte pjesë në këto lloj shfaqjesh.*
4. *Salla në të cilën aktorët bëjnë prova në institucion është shumë e ftohtë dhe nuk ka asnjë mjet ngrohje. Këto kushte mund të kenë ndikuar dhe në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të ankuesit.*

*Ankuesi pretendon se nga ana e QKKF-s janë shkelur dispozitat ligjore dhe detyrimet që ky institucion ka lidhur me përshtatjen e arsyeshme të personave me aftësi të kufizuar dhe ka lejuar në këtë mënyrë që situata të kthehet në diskriminuese për ankuesin. QKKF-ja me mos marrjen e masave për të bërë përshtatjen e arsyeshme, e domosdoshme për ankuesin e ka vendosur atë në një pozitë të pabarabartë me kolegët e tjerë dhe në këtë mënyrë ai nuk ushtron dot në të njëjtën mënyrë si të tjerët të drejtat e tij”.*

Subjekti ankues kërkon marrjen e masave së detyrimit të autoriteteve për të bërë vlerësimin e aftësisë së kufizuar të ankuesit si dhe cilat janë ndërhyrjet e nevojshme që duhet të bëhen në infrastrukturë apo programatiken e institucionit në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja efektive dhe e barabartë e tij në aktivitetet kulturore për të cilat ai është kontraktuar dhe vlerësuar si i aftë ti kryejë.

Ankesa e A.Z është paraqitur dhe mbështetet nga organizata jofitimprurëse “Shërbimi Ligjor Falas, Tiranë” TLAS.

Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar është një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji 10221/2010, neni 3/7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet se: *“Mohim i një përshtatje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.*

Ligji 10221/2010 ka parashikuar në Nenin 7/1 *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga ankuesi, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën Nr. 217/1, datë 18.02.2016 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatri i Kukullave në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga A.Z.
- Me shkresën Nr. 217/3, datë 25.03.2016 i është kërkuar përsëri informacioni subjektit, Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, në lidhje me ankesën.

Me datë 22.04.2016, në zbatim të Urdhrit të Inspektimit nr.68, datë 18.04.2016 inspektorët e Komisionerit u paraqitën pranë zyrave të subjektit QKKF, Teatri i Kukullave për të realizuar inspektimin por në takim nga ana e V.Ç me detyrë specialiste e buxhet financës u njoftuan se drejtuesit e institucionit që nga data 18.04.2016 janë në një turne artistik jashtë vendit. Në këto kushte inspektimi nuk u zhvillua.

Për sa më lart dhe mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve.

Me shkresën nr. 475 prot, datë 27.04.2016, është bërë njoftimi i palëve për realizimin e seancës dëgjimore më datë 05.05.2016, ora 10<sup>00</sup>, pranë Zyrave të KMD-së.

Në datë 05.05.2016 në orën 10.<sup>00</sup>, M.Z në cilësinë e juristes së QKKF-s njoftoi nëpërmjet telefonit se titullari i institucionit nuk mund të merrte pjesë në seancën dëgjimore për shkak të një impenjimi urgjent në Ministrinë e Kulturës. Në këto kushte, seanca dëgjimore nuk u zhvillua.

Më shkresën datë 13.05.2016, organizata “Shërbimi Ligjor Falas, Tiranë” ka informuar Komisionerin se nga ana e institucionit të QKKF-s, A.Z i është kërkuar që të performojë në skenë në fundjavën e dytë të muajit Maj 2016 në një nga rolet tek i cili A.Z ka veçanërisht vështirësi, sidomos në kushtet aktuale shëndetësore. Pavarësisht gjendjes shëndetësore të tij dhe faktit që A.Z kishte kohë pa bërë prova dhe pa u ngjitur në skenë ai ka pranuar të realizojë shfaqjen, referuar egos së tij profesionale si dhe për të mos refuzuar vendimmarrjen e eprorit të tij pavarësisht faktit se loja e tij aktoriale do të dilte jo në lartësinë e pretenduar nga aktori bazuar në aftësitë e tij profesionale. Bazuar në këtë fakt ankuesi pretendon se është viktimizuar nga punëdhënësi si rezultat i ankimit që ka paraqitur tek institucioni i Komisionerit.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 80, datë 13.05.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë QKKF, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e A.Z”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë QKKF, më datë 19.05.2016, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë QKKF, inspektorët e KMD-s, morën takim me M.L, me detyrë Drejtore e QKKF-s dhe M.Z me detyrë specialiste juriste.

Gjatë inspektimit M.L informoi se: *“Institucioni ka lidhur kontratë 6-mujore jo vetëm me A.Z por dhe me aktorë të tjerë siç janë: K.R, M.S, G.D dhe Zh.D, duke marrë në konsideratë mos përmbushjen e detyrave funksionale dhe performancën e dobët për periudhën kohore të vitit 2015. Regjisorët D.D, V.B dhe K.Y, nuk e kanë përzgjedhur aktorin A.Z për të luajtur në veprat e tyre për shkak të gjendjes së rënduar fizike i cili nuk lëviz dot në skenë. E gjithë struktura organizative e institucionit që u ndryshua u bë vetëm që A.Z ti gjendej punë dhe jo në vendet që ka pretenduar A.Z (roje apo biletashitës) por në një pozicion më të arsyeshëm me diplomë. Në periudhën kohore nga viti 2013 deri më sot në teatrin e kukullave nuk ka patur shfaqje me grupë. Për dy vjet e gjysmë A.Z nuk është paraqitur asnjë ditë në punë. Nga viti 2015 gjendja e A.Z në skenë është tepër e rënduar dhe A.Z duhet të dalë në KMCAP për gjendjen e tij shëndetësore pasi institucioni nuk është në gjendje ta vlerësojë atë”.*

Në vijim të inspektimit, M.Z informoi se, QKKF-ja është vënë në dijeni të shkresave me nr. 217/1, datë 18.02.2016 dhe nr. 217/3, datë 25.03.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi respektivisht ato janë protokolluar me nr. 44 prot., datë 22.02.2016 dhe nr. 44/1 prot., datë 29.03.2016. Gjithashtu M.Z informoi se për vitin 2015 nuk ka patur vlerësim me shkrim të punës për aktorët por vlerësimi është bazuar në tabelën e numrit të shfaqjeve dhe me anë të komunikimeve të drejtores me aktorët gjatë mbledhjeve çdo ditë të martë. Gjatë inspektimit në procesverbalin e mbajtur me këtë rast nga ana e inspektorëve është lënë detyrë për QKKF-n që të dërgonin pranë zyrës së KMD-s kopje të dokumenteve të mëposhtme: Rregullore e funksionimit të Bordit Artistik, Statuti i QKKF dhe kopje të librit të procesverbaleve të mbledhjeve të institucionit për periudhën Tetor-Dhjetor 2015. Në dosjen personale të punonjësit A.Z u verifikua se në mes të tjerash gjendeshin dhe këto dokumente: Vërtetim KMCAP, datë 14.01.2014, raport i ekspertëve mjekësorë datë 25.04.2001, nr. 75, datë 08.01.2003, raport Mjeko-Ligjor 2007, Fletë drejtimi për KMCAP datë 15.06.1997.

Me shkresën nr. 700/1, datë 07.07.2016 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar QKKF-n me Vendimin nr.116, datë 07.07.2016 në të cilin institucioni i QKKF-s është gjobitur në vlerën 100.000 lek për mosdhënie informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me shqyrtimin e çështjes së A.Z.

Me shkresën nr 111/1, datë 18.07.2016, QKKF-ja, në mes të tjerash informon Komisionerin se: *“Aktori A.Z ka munguar vazhdimisht në punë duke pasur probleme shëndetësore me fizikun e tij, pasi përgjatë vitit 2015 dhe 6-mujorit të parë të vitit 2016 ai ecën vetëm me paterica duke mos iu*

*përgjigjur rolit dhe punës në çdo moment. Në këto kushte është e pasigurt për ta detyruar punonjësën të interpretojë në skenë edhe pse dëshira e A.Z është e madhe. Rolet e A.Z nuk mund të zëvendësohen as nga aktorët e tjerë, pasi maskotat e përdorur nga ai ndër vite, janë tepër personale dhe nuk i përshtaten fizikut të kolegëve të tjerë. Një javë përpara se të mbaronte kontrata e punonjësës, M.L i ka propozuar A.Z një pozicion të ri pune, si specialist pranë Sektorit të Krijimtarisë Artistike të QKKF-s. A.Z nuk i është përgjigjur propozimit të titullarit edhe pas vënies në dispozicion për ta studiuar rinovimin e kontratës, në pozicionin si specialist”.*

Me shkresën nr. 745/1, datë 22.07.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar QKKF-n për Vendimin nr. 124, datë 22.07.2016 në të cilin ka vendosur shfuqizimin e Vendimit për qejbë nr.116, datë 07.07.2016 pasi mori në dispozicion dokumentacionin e kërkuar.

### **Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson:**

*“Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr. 108/2012, datë 15.11.2012, ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet kryesore të kësaj Konvente. Në kuptim të kësaj Konvente, personat me aftësi të kufizuara përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë<sup>1</sup>.*

Shqipëria e ka formalizuar vullnetin e vet për zbatimin e këtyre detyrimeve në fushën e punësimit, përmes miratimit të ligjit 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Në kuptim të këtij ligji në nenin 3/9 përkufizohet se: ““Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët”.

Në analizë të shkakut të parashtruar nga subjekti ankues, vërtetohet se A.Z është shpallur si person që plotëson kushtet për invaliditet të Gr. II prej datës 01.02.2014 deri më datë 01.02.2017 meqenëse vuan nga sëmundja: Nanizmi hipofizar, e vërtetuar kjo me Vendimin nr. 199, datë 14.01.2013 të KMCAP Tiranë. Gjendja e aftësisë së kufizuara të A.Z është e shoqëruar dhe me një situatë të përkeqësuar të gjendjes së tij shëndetësore me diagnozë: Dischopathio vert. Lumbosacralis L3-L4-L5-S1, të vërtetuar nga Klinika e Fizioterapisë “Ohri-Medical” Tiranë më datë 30.03.2016.

<sup>1</sup> Konventa mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe Protokollin Opsional, Neni 1.

Referuar librezës së punës, Nr. i regjistrimit themeltar 88, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Teatri Kukullave, të subjektit ankues A.Z, rezulton se ka qenë në marrëdhënie pune pranë këtij institucionit që prej datës 01.06.2005 në detyrën si aktor. Në datë 11.12.2015 mes A.Z dhe institucionit është lidhur kontrata individuale e punës me afat 6-mujor. Detyrën e aktorit pranë QKKF-s A.Z e ka kryer deri në datë 11.05.2016, kohë kur ka përfunduar dhe afati i kontratës.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar dhe deklaratave të subjekteve vlerësohet se situata e gjendjes shëndetësore të A.Z ka qenë jo e mirë që prej periudhës së vitit 2015 e në vazhdim por kjo situatë nuk e ka penguar A.Z që përmbushë detyrimet e kontratës së tij të punës, pasi referuar tabelës mbi numrin e shfaqjeve për periudhën Janar 2014 deri në 30.04.2016 vërehet se A.Z ka marrë pjesë në 4 premiera dhe numri i shfaqjeve për vitin 2014 ka qenë 24, për vitin 2015 ka qenë 26 shfaqje dhe 4-mujorin e parë të vitit 2016 ka qenë 3 shfaqje. Po ashtu referuar dhe dokumentit: Informacion për aktivizimin në role të punonjësit A.Z për gjatë periudhës kohore 2009-2015, vërtetohet se A.Z ka marrë pjesë për vitin 2014 në 3 premiera dhe në vitin 2015 ka marrë pjesë në 4 premiera<sup>2</sup>.

Në nenin 6 të Statutit të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, nr.186 prot, datë 18.10.2012, përcaktohet se: *“Të drejtat dhe detyrimet e bordit artistik – Bordi artistik ka këto detyra:- Të ngrejë komision të specializuar (periodik) për vlerësimin dhe nivelin artistik të artistëve, dhe trupës artistike me pikëzime sipas VKM. Nr. 1173 datë 06.11.2009, pika 8, sipas kërkesës së Ligjit të Artit”*.

Po ashtu, në nenin 11/1 të Rregullores së Brendshme të QKKF-s përcaktohet se: *“Audicioni për vlerësimin periodik të performancës të artistëve të punësuar në QKKF, TK kryhet çdo vit, ndërmjet datave 15 Nëntor dhe 15 Dhjetor dhe ka për qëllim përcaktimin e nivelit dhe meritës artistike të punonjësit të institucionit gjatë një viti kalendarik”*.

Në drejtim të përmbushjes së këtij detyrimi mbi vlerësimin e performancës së A.Z dhe të aktorëve të tjerë nga ana e QKKF-s nuk disponohej një vlerësim me shkrim dhe nuk u arrit që të jepeshin shpjegime të arsyeshme dhe objektive se aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore e A.Z ka ndikuar në mosrealizimin e detyrave të tij si aktor dhe për këtë arsye duhet të bëhej dhe ndërprerja e kontratës së punës.

Referuar dokumenteve të administruara në dosjen personale të punës së A.Z vlerësohet se ai ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj institucionit, pasi gjatë periudhës 2014-2016 nuk është ndëshkuar asnjëherë me masë disiplinore dhe në asnjë rast nuk ka të dokumentuar se ka shkelur detyrimet kontraktore.

---

<sup>2</sup> Referuar dokumentacionit të administruar gjatë inspektimit të datës 19.05.2016.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se performanca në punë e A.Z nuk ka qenë shkak i mos rinovimit të kontratës së punës pasi në asnjë rast nga ana e QKKF-s nuk u arrit që të paraqitej një dokument që të provonte performancën e dobët dhe mos përmbushjen e detyrave nga ana e A.Z.

Në analizë të shkakut të pretenduar nga ankuesi dhe bazuar në nenin 82, pika 2, të Ligjit Nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative, ku parashikohet: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*, QKKF-ja nuk vuri në dispozicion të Komisionerit prova, që të vërtetonte performancën e dobët dhe mos përmbushjen e detyrave të A.Z dhe se vendimi për mos rinovimin e kontratës së A.Z përbën një masë proporcionale për të ndjekur një qëllim të ligjshëm.

Referuar, Procesverbalit nr. 163/11, datë 12.11.2015, të mbajtur gjatë takimit të zhvilluar ndërmjet drejtuesve të QKKF-s dhe avokates që ka përfaqësuar A.Z, provohet se gjatë këtij takimi A.Z ka kërkuar nga drejtuesit e institucionit, që referuar gjendjes së tij shëndetësore dhe gjatësisë së tij, ti ofrohej mundësia e përshtatjes së skenës me teknik grope për të realizuar rolet me kukull<sup>3</sup> apo ndërhyrje në programatiken e institucionit, por nga ana e QKKF-s nuk është ndërmarrë asnjë veprim për krijimin e kushteve në mënyrë që A.Z të realizonte apo përshtaste rolin e tij.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3, pika 1, sanksionon: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*. Mos krijimi i kushteve të përshtatshme për aktrim nga ana e QKKF-s, e ka vendosur A.Z në një pozitë të pabarabartë me kolegët e tjerë për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes së tij shëndetësore duke përbërë një sjellje të pajustificuar dhe duke reflektuar dukshëm<sup>4</sup> një qëndrim diskriminues ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, *“Mohim i një përshtatje të arsyeshme është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet*

<sup>3</sup> Dialogu faqe 5: Drejtor i Përgjithshëm- “Ne s’mund të krijojmë role me karrocë. Çfarë roli ke luajtur me kukull? A.Z nuk ke luajtur asnjëherë me kukull. ....”. Aktori A.Z: - “S’ke të drejtë të më gjykosh në interpretimin e kukullës, ka stile të ndryshme si: stile me maskot, hije, marioneta dhe petrushkë. Unë bëj zgjidhje me kukull spirale për të interpretuar me teknik grope që e përshtat me gjatësinë time e adaptoj vet”.

<sup>4</sup> Referuar, Procesverbalit nr. 163/11, datë 12.11.2015:- Drejtori: Kam përgjegjësi për fëmijët në mënyrë estetike dhe s’mund të dalësh me paterica në skenë.....ky është institucion që fëmijët e kanë dashur, por s’mund ta nxjerr me karrocë invalidi.

*gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”*

Në nenin 5, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, sanksionohet: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mos marrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë; 2. Mohimi i modifikimeve dhe përshtatjeve të duhura e të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara përbën diskriminim”. Mbështetur në provat dhe faktet e grumbulluara, nuk rezulton që nga ana e QKKF-s, të jenë bërë përpjekje për të llogaritur mundësinë e përshtatjes apo marrjen e masave për modifikimin e skenës, për të bërë të mundur ushtrimin e profesionit të aktrimit të A.Z në kushte të barabarta me të tjerët, mohimi i përshtatjes së skenës dhe mos marrja e masave nga ana e QKKF-s, e ka vënë A.Z në pozita diskriminuese.

Në lidhje me pretendimin e subjektit ankues se shkak për përkeqësimin e gjendjes së tij shëndetësore ka qenë lagështia dhe mjedisi i ftohtë i QKKF-s, Komisioneri vlerëson se nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar një pretendim të tillë, pasi në mjediset QKKF-s funksionon sistemi i ngrohjes me kaldajë.

Për sa më lart, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në vlerësim të të dhënave të mësipërme, Komisioneri vlerëson se ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit A.Z nga ana e QKKF, TK ka qenë diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar të A.Z.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 3/1, 3/7, 5 dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 10 dhe 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të shtetasit A.Z, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatri i Kukullave.
2. Në referim të pikës 1, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Teatri i Kukullave, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e A.Z në vendin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Teatri i Kukullave, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë)



ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**